

KËRKESË
Nr. 4865/4, datë 13.11.2015
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi dhe asfaltimi i Rrugës nga Muzeu Historik - Spitali, Vlorë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët për të cilët është bërë shënimi “Saktësim dokumentacioni”, do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 18,146,972 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani

Lista e objekteve që preken nga projekti: “Sistemim asfaltimi i rrugës nga Muzeu Historik - Spitali Vlorë”

Nr	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Adresa	Pronari	Sipërfaqe Truallit	Sipërfaqe ndertimi	Çmimi i Truallit Leke/m2	Çmimi i Ndertimit Leke/m2	Vlera e Truallit Leke	Vlera e Ndertimit Leke	Vlera truallit dhe ndertese	Shenime sipas ZVRPP dhe dok. të dorëzuar
1	8601	7/200	Vlorë	Kozma Tata	114	56	7,002	14,808	798,228	829,220	1,627,448	Certifikate pronësie
2	8601	7/159	Vlorë	Ardian Dauti	0	66	7,002	14,808	0	878,287	878,287	Certifikate pronësie është mbajtur vlera e truallit për ndërtimin jashtë vijës së shpronësimit
3	8601	7/101	Vlorë	Liri Shehu	27.98	0	7,002		195,916	0	195,916	Certifikate pronësie
4	8601	7/24	Vlorë	Aranit Ibrahimaj		21	7,002	14,808	0	310,958	310,958	Vendim gjykate
5	8601	7/22	Vlorë	Fitim Veizaj	0	20	7,002	14,808	0	296,160	296,160	Certifikate pronësie
6	8601	4/1	Vlorë	B.P. Xhemali	53.03	100	7,002		371,316	5,734,457	6,105,773	Certifikate pronësie është mbajtur vlera e truallit për ndërtimin jashtë vijës së shpronësimit
7	8601	3/25	Vlorë	Mahmut Balleshi	33.96	0	7,002		237,788	0	237,788	Certifikate pronësie
8	8601	3/86	Vlorë	Mahmut Balleshi	42.7	0	7,002		298,985	0	298,985	Certifikate pronësie
9	8601	3/24	Vlorë	Vilson Balleshi, Petrit Ba	7.18	109.2	7,002		50,274	0	50,274	saktësim dok.për truallin/P.P.V
10	8601	2/76	Vlorë	Pellumb Ymeraj	16.17	107	7,002		113,222	5,886,312	5,999,534	sak. dok.Certifikate pronësie
11	8601	2/75	Vlorë	Enver Resuli	0	36	7,002	61,655	0	2,145,849	2,145,849	Vendim gjykate
18,146,972												

V.o.: Çmimi i truallit është marrë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.7.2014.

Çmimi i ndërtesës sipas ZVRPP-së.

Çmimi i objektit të banimit sipas udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014.